V E N D I M
Nr.126, datë 25.3.1994

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MIMISTRAVE NR.621, DATË 20.12.1993, DHE NJË SHTESË NË URDHËRESËN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.7, DATË 17.8.1993

Me propozimin e Ministrisë së Transporteve dhe Komunikacioneve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 20.12.1993 "Për kompetencat në dhënien e lejeve për ushtrimin e veprimtarive në fushën e transporteve dhe të komunikacioneve", në listën e bashkëlidhur, në faqen e dytë, titulli "Nga këshillat e rretheve dhe Bashkia e Tiranës" të ndryshohet si vijon:

"Nga bashkitë e qyteteve për transportin e udhëtarëve dhe nga këshillat e rretheve dhe Bashkia e Tiranës për fushat e tjera të transportit automobilistik".

2. Në urdhëresën e Këshillit të Ministrave nr.7, datë 17.8.1993 "Për transportin rrugor publik të udhëtarëve dhe bagazheve", në nenin 20, në vazhdim të paragrafit të parë të shtohet fjalia "Kur brenda një rrethi janë me shumë se një bashki, linjat që lidhen me bashkinë e qendrës së rrethit miratohet nga vetë ajo", kurse në rreshtin e dytë të paragrafit të dytë, pas fjalës "komunat" të shtohen fjalët "dhe bashkitë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MIMNISTRAVE
Aleksandër Meksi